



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.50/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët : Skender Çoçaj kryesues, Bujar Muzaqi dhe Hajriz Hoti, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e [redacted] dhe [redacted] të parashtruar ndaj KQZ-së, për shkak të përjashtimit në lidhje me aplikimin për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 23.09.2025, mori këtë :

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ANKESA ZL.Anr 50/2025 e datës 20.09.2025, e parashtruar nga [redacted] dhe [redacted] për shkak të përjashtimit në lidhje me aplikimin për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Më datë 20.09.2025, PZAP-i, përmes emailit zyrtar ka pranuar ankesë ZL.Anr.50/2025 nga [redacted] dhe [redacted] me vendbanim në Dragash kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak se të njëjtit kanë qenë të regjistruar në listën e votuesve jashtë vendit dhe figuronim në listën para përfundimtare.

Parashtruesit e ankesave theksojnë se aktualizimi i listës është bërë vetëm disa orë para përfundimit të afatit për regjistrim përmes postës jashtë vendit, duke bërë të pamundur që të paraqesim ankesë brenda kohës së paraparë.

Në listën e publikuar nga KQZ, në listën përfundimtare, heqja jonë nga lista paraqet cenim të drejtpërdrejt të të drejtës kushtetuese për të votuar, të garantuar nga neni 45 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nga Ligji për Zgjedhjet. Ky veprim është i papranueshëm dhe përbën shkelje të së drejtës sonë demokratike, duke cenuar integritetin e procesit zgjedhor.

Dokumentet e paraqitura si prova: dëftesat e aprovimit, lista e votuesve jashtë Kosovës.

Me datë 22.09.2025 PZAP-i ka bërë kërkesë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për përgjigje në ankesë deri në orën 16:00 h, për të cilën nuk kemi pranuar përgjigje nga ana e tyre.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të ankesës të parashtruar nga ankuesi, vëren se të njëjtat janë të pa bazuara. Paneli, pasi që shqyrtoi pretendimet ankimore konstatoi se:

Ankesa është e pa bazuar

Paneli, pasi shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi se ankesat e ankuesve janë të pabazuara, pasi që parashtruesit e ankesave gjatë aplikimeve të tyre për regjistrim për votim jashtë Kosovës nuk i kanë plotësuar kriteret e kërkuara sipas paragrafit 4 të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 04/2025, Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës të KQZ-së, në të cilin është përcaktuar se *"4. Kërkesa për regjistrim përmes platformës elektronike të KQZ bëhet si në vijim: 4.1. Plotëson të dhënat e adresës së banimit jashtë Kosovës: shtetin, kodin postar, qytetin, emrin e rrugës, numrin e banesës apo shtëpisë; 4.2. Plotëson email adresën personale dhe numrin e telefonit mobil personal; 4.3. fotografon njërin prej dokumenteve identifikuese të lëshuara nga Republika e Kosovës, si letërnjoftim, pasaportë ose patentë shofer, duke mos përjashtuar dokumentet me afat të skaduar; 4.4. fotografon dokumentin që dëshmon adresën e votuesit jashtë Kosovës, sikurse në nën paragrafin 4.1..."*.

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndëve dhe përgjigjes së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Paneli arriti në përfundimin se, parashtruesit e ankesave janë verifikuar nga KQZ dhe nga verifikimi i këtyre dëshmimeve është konstatuar se parashtruesit e ankesave me rastin e aplikimit për regjistrim për votim jashtë Kosovës përmes platformës elektronike të KQZ-së, nuk kanë dhënë numër të telefonit funksionalë dhe Email adresa e përdorur nuk përputhet me të dhënat e votuesve, pra nuk është adresë personale, dhe si e tillë është në kundërshtim me nënparagrafin 4.2 të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 04/2025 "Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës", ku kërkohet që aplikuesi të plotësojë adresën personale të emailit dhe numrin personal të telefonit mobil.

Bazuar në të lartcëkurat, PZAP konstaton se në këtë çështje, drejtë është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të ankuesve, andaj pretendimet e ankuesve nuk janë të bazuara.

Në këto rrethana, Paneli vlerësoi se parashtruesit e ankesave nuk ka plotësuar njërin nga kriteret thelbësore të përcaktuara në kuadër të procesit të regjistrimit për votim jashtë vendit, konkretisht kriterin që lidhet me dëshminë e adresën personale të emailit dhe numrin personal të telefonit mobil, kriter ky i përcaktuar shprehimisht me nen 3 paragrafi 5 pika 5.1 të Rregullores Zgjedhore Nr.04/2025 Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës, të nxjerrë nga KQZ.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 paragrafi 3, 118 paragrafi 1, neni 119 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, lidhur me neni 3 paragrafi 5 pika 5.1 e Rregullores të sipërcituar, dhe në bazë të Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
ZL.Anr. 50/2025 më datën 23.09.2025

Kryesues i Panelit,
Skender Çoça



KËSHILLAJURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.